V E N D I M
Nr. 61, datë 29.3.2002

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Zija Vuci	Anëtar i ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 15.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27 Akti që i përket:

KëRKUES:RIZA MULLETI, përfaqësuar nga avokat Fatmir Bimbashi, me deklarim.
SUBJEKTE Të INTERESUARA:
1. SALI ANGONI, përfaqësuar nga avokat Jusuf Alibali, me deklarim.
2. ENGJELL ANGONI, përfaqësuar nga avokat Jusuf Alibali, me deklarim.
3. KIMETE ÇAUSHI, përfaqësuar nga avokat Jusuf Alibali, me deklarim.
4. NEZAQET DULI, përfaqësuar nga i biri, Bashkim Duli.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.755, datë 13.7.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.R-17, datë 6.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 11/2 të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtyre vendimeve kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dalë jashtë kompetencave të veta. Ai ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave nga gjykatat e shkallëve më të ulta, madje ka pranuar edhe prova të tjera, të cilat nuk janë marrë parasysh nga këto gjykata.

- Konkluzioni i tij është kontradiktor, sepse nga njëra anë pranon që trualli prej 24 m2 nuk është i lirë, nga ana tjetër thotë se gjysma e tij që nuk ndodhet mbi trotuar është e lirë. Në qoftë se është kështu, për këtë pjesë, Kolegji duhej të pranonte dhe jo të rrëzonte padinë.

- Parregullsia e këtij procesi konsiston në faktin se Kolegji Civil ka vendosur rrëzimin e kësaj padie edhe për mungesë legjitimimi, në një kohë që në ngritjen e saj kërkuesi ka interes. Kjo për arsye se së bashku me dyqanin ai ka blerë me truallin, i cili është i regjistruar në hipotekë.

- Rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor është edhe vendimi i Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Çështjen ky Kolegj nuk duhej ta zgjidhte në Dhomën e Këshillimit me mospranim të rekursit, por duhej ta kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore, përderisa në këtë rekurs kërkuesi ka ngritur probleme ligjore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Zija Vuci, përfaqësuesit e kërkuesit dhe të subjekteve të interesuara si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë së Tiranës u ka kthyer subjekteve të interesuara, Sali Angoni, etj., godinën e tyre ish-pronë private e ndodhur kjo në Rrugën e "Durrësit", Tiranë.

Mbi këtë bazë, ata i janë drejtuar gjykatës duke kërkuar detyrimin e kërkuesit, Riza Mulleti, që t'u lirojë e dorëzojë atyre truallin prej 24 m2 mbi të cilin ndodhet kioska e privatizuar prej tij në vitin 1992. Kërkuesi në këtë gjykim ka ngritur kundërpadi duke kërkuar detyrimin e tyre për njohjen e tij pronar mbi këtë sipërfaqe trualli.

Gjykata e Rrethit të Tiranës me vendimin nr.1849, datë 13.5.1998, ka vendosur pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.1299, datë 25.9.1998, ka prishur vendimin e gjykatës së faktit duke vendosur rrëzimin e padisë së subjekteve të interesuara dhe pranimin e kundërpadisë së kërkuesit. Kundër këtij vendimi subjektet e interesuara kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Civil i kësaj Gjykate, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, me vendimin nr.755, datë 13.07.1999, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit në pjesën që ka rrëzuar padinë dhe ndryshimin e tij në pjesën tjetër duke rrëzuar si të pabazuar edhe kundërpadinë.

Ndaj këtij vendimi ka reaguar me rekurs në interes të ligjit vetëm kërkuesi Riza Mulleti. Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.R-17, datë 6.6.2001, ka vendosur në Dhomën e Këshillimit mospranimin e këtij rekursi si të pabazuar në ligj.

Në kundërshtim me sa ka pretenduar kërkuesi, nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë del se kjo instancë gjyqësore shqyrtimin e çështjes e ka përqëndruar vetëm në kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të Gykatës së Apelit. Konkluzionet e tij ky Kolegj i ka bazuar në ato prova që janë administruar në gjykimin e shkallës së dytë, pa u bërë atyre një vlerësim të ri ose të ndryshëm. Madje, ashtu si gjykata e apelit edhe Kolegji Civil kanë pranuar se trualli objekt konflikti nuk është truall i lirë, pasi ky send ndodhet në përdorim publik.

Është kjo arsyeja nga e cila është nisur Kolegji Civil për të lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit në pjesën që rrëzonte padinë e subjekteve të interesuara duke pranuar edhe mungesën e legjitimitetit të tyre në ngritjen e kësaj padie.

Mbi këtë bazë, ky Kolegj ka ndryshuar edhe pjesën tjetër të këtij vendimi duke rrëzuar edhe kundërpadinë e kërkuesit. I ndodhur përpara kësaj situate, Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke iu përmbajtur objektit të rekursit të ushtruar vetëm nga kërkuesi dhe jo edhe nga subjektet e interesuara, ka vendosur në Dhomën e Këshillimit mospranimin e këtij rekursi.

Pretendimet e tij se problemeve që ai ka ngritur në këtë rekurs duhet t'u jepej përgjigje në seancë gjyqësore nuk janë të bazuara. Ato nuk kanë të bëjnë me asnjërin prej shkaqeve të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, prandaj me të drejtë Kolegji Seleksionues ka vendosur të mos e kalojë këtë çështje për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara. Në këto rrethana, vendim i tij, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, nuk përmban elementë të një procesi jo të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I :

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.